



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "NAZMI RUSHITI" DIBËR

Nr. 268 prot.

Peshkopi, më 14 . 01 .2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
TIRANË

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit:të ligjit nr.15/2017,datë 16.02.2017 " Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",të vendim të Këshillit të Ministrave nr. 554,datë 31.07.2019, "Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive datë si dhe Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024 " Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë,menaxhimin e burimeve njerëzore,përberjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"

Ofruesi publik i AFP - së - shkolla e mesme profesionale "Nazmi Rushiti " Dibër, ju njofton krijimin e vendit të lirë : për pozicionin :

-Sanitare-1(një) vend vakant (Bulqizë)

A-Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

1 – Kriteret e përgjithshme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon :

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon :

- a) Të ketë nivelin arsimor të mesëm ose shkollë të mesme profesionale, në fushën në shpalljen për pozicionin përkatës
- b) Të ketë përvojë në punë të paktën një vit sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës

B-Dokumentet e aplikimit

Dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës II të këtij udhëzimi
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomë/dëftesën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- i) vërtetim banimi

- ✓ Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.
- ✓ Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda datës 23.01.2025

DREJTORI

Majlinda POÇI

